

PËRMBLEDHJE

Kosovë



Rritja ekonomike mbetet e qëndrueshme pavarësisht pasigurive të rritura të brendshme dhe të jashtme, e mbështetur nga aktiviteti i konsumit dhe investimeve. Në afat të mesëm, rritja pritet të qëndrojë afër 4 përqind.

Në vitin 2025, presionet e inflacionit u rishfaqën, të nxitura nga çmimet më të larta të energjisë dhe ushqimit, duke gërryer të ardhurat reale të disponueshme.

Vonesat e zgjatura në formimin e një qeverie të re mund të ndikojnë negativisht në investime dhe të ngadalësojnë progresin në reformat strukturore, me ndikime të dëmshme në rrugën e parashikuar të rritjes.

Pas rritjes me 4.4 përqind në vitin 2024, rritja ekonomike e Kosovës u ngadalësua në 3.6 përqind në tremujorin e parë të vitit 2025, ndërsa konsumi i amvisërive u ul dhe kërkesa e jashtme u dobësua. Pagat reale u rritën me 10.3 përqind në vitin 2024, të mbështetura nga një pagë minimale më e lartë, por punësimi formal u rrit vetëm në mënyrë modeste, mesatarisht 1.4 përqind në gjysmën e parë të vitit 2025.

Kërkesa më e lartë e brendshme, përfshirë konsumin më të lartë qeveritar, së bashku me rritjen e çmimeve të ushqimit, pijeve, energjisë elektrike dhe shërbimeve, nxitën inflacionin në gjysmën e parë të vitit 2025. Inflacioni i konsumit arriti në 4.3 përqind në korrik 2025, duke e çuar mesataren janar-korrik në 3 përqind. Rreziqet e sektorit fiskal dhe financiar mbeten të kufizuara, duke siguruar një sfond të qëndrueshëm për ekonominë pavarësisht ngadalësimit të rritjes ekonomike.


Rritja ekonomike e Kosovës mbetet e fortë dhe mund të nxitet më tej me rritjen e konkurrencës dhe diversifikimit. Rritja e pjesëmarrjes së grave në fuqinë punëtore mund të zhbllojë më tej potencialin për rritje ekonomike dhe, në këtë drejtim, adresimi i mungesës së kujdesit të përballeshëm për fëmijët është kritik.

Carole Megevand
 Menaxhere e Bankës Botërore për Kosovën
 dhe Maqedoninë e Veriut


Rritja ekonomike pritet të stabilizohet rreth potencialit të Kosovës prej 4 përqind në aspektin afatmesëm. Vonesat e zgjatura në formimin e një qeverie të re mund të ngadalësojnë zbatimin e axhendës së reformave strukturore dhe të vonojnë qasjen në financim të jashtëm, përfshirë edhe në Planin e Rritjes për Ballkanin Perëndimor të BE-së. Pasiguria e vazhdueshme gjeopolitike dhe një dobësim i mëtejshëm i kërkesës së jashtme mund të rëndojnë mbi eksportet dhe Investimet e Huaja Direkte, me ndikime të dëmshme në rritjen ekonomike.

Rritja reale e BPV-së

Përqindja


Përbërja e rritjes vjetore

Pikë përqindjeje



Burimi: Agjencitë kombëtare të statistikave dhe vlerësimet e stafit të Bankës Botërore.

Vërejtje: WB6 = Gjashtëshja e Ballkanit Perëndimor; e = vlerësim.



Për më shumë informacion dhe botimet e mëparshme të Raportit të Rregullt Ekonomik të Ballkanit Perëndimor, klikoni [këtu](#).